- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk merr në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk merr në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e paleve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lenë menjëherë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Perkufizime**

- 2.1 “kontrate” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbehet nga Dokumentat e Tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha shtojcat dhe formularet e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “çmimi kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plote dhe të përpikta të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Incoterms” do të thotë termat ndërkombëtare tregtare që përbejnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë detyrimet përkatëse, kostot, dhe risqet e lidhura me transferimin e Mallrave nga shitesi tek blerësi.
- 2.4 “Levrimi” do të thotë të gjitha aktivitetet dhe veprimet që mundësojnë marrjen e Mallrave në vendin e shpërndarjes siç specifikohet në kontratë si paketimi, transportimi, sigurimi, tarifat, procedura doganore, ngarkimi dhe shkarkimi, instalimi, mbledhja, bashkimi, kontrollimi i veprimeve dhe mbikeqyrja e gjithë kësaj veprimtarie.

- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thote Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen Mallrat. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtit me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thote personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon Mallrat.
- 2.7 “Palë (t)” do të thote nënshkruesit e kontratës.
- 2.8 “Mallrat” do të thote materialet e papërpunuara, produktet, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurte, të lëngshme ose të gazte.
- 2.9 “Shërbimet e lidhura me to” do të thote shërbimet ndihmëse ose të paparashikuara të furnizimit të Mallrave, si transportimi, instalimi, mirëmbajtja, trajnimi, shërbimet mbështetëse ose detyrime të ngjashme në lidhje me furnizimin e Mallrave.
- 2.10 “Objekt i kontratës” do të thote të gjitha Mallrat dhe Shërbimet e lidhura me to që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.11 “Standarde Teknike” do të thote specifikimet e aprovuara nga një organ i posaçëm standardizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të parashikuar në Dokumentat e Tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trëpëzuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikë e Korrupsionit, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korrupsive. Veprimet korrupsive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ndonjë ent tjetër që ka marrë pjesë në përgatitjen e Dokumentave të Tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar për nenkontraktuesin të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nen-Kontraktuesin një dispozitë që parashikon ruajtjen e konfidencialitetit siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### **Neni 6: Pronesia Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetin Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Kontraktuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i parashtrijë Autoriteti Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kane lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të shkarkojë Autoritetin Kontraktor nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose shpërndarja e Mallrave sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i Mallrave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Mallrave**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombesinë e origjinës së mallrave, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktuesi mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e mallrave.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, "origjine" do të thotë vendi ku mallrat janë nxjerrë, ose prodhuar. Mallrat janë prodhuar kur, nëpërmjet përpunimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponenteve, rezultojnë një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentet e tij.

- 7.4 Origjina e mallrave ka dallim nga kombesia e Kontraktuesit ose nenkontraktuesit qe siguron mallrat.

#### **Neni 8: Qellimi i Furnizimit dhe Pershtatshmeria e Mallrave me Specifikimet**

- 8.1 Kontraktuesi duhet te dorezoje Mallrat ne perputhje me cilesine, sasine dhe llojin e specifikuar ne kontrate, si dhe te vendosura dhe paketuara ne menyren e percaktuar ne kontrate.
- 8.2 Mallrat nuk jane ne perputhje me kontraten, nese ato nuk jane te pershtatshme per perdorimin e posaçem te parashikuar ne kontrate. Kur nuk eshte e mundur te percaktohet nje gje e tille, thuhet se Mallrat nuk jane ne perputhje me kontraten nese ato nuk jane te pershtatshme per perdorimin per te cilin sherbejne zakonisht sendet e tjera te te njejtit lloj.
- 8.3 Nese shitja eshte bere ne baze te nje modeli ose kampioni, shitesi (Kontraktuesi) duhet te dorezoje sendet qe kane te njejtat cilesi si te modelit ose kampionit.

#### **Neni 9: Perputhshmeria e Mallrave me Standardet Teknike**

- 9.1 Mallrat e furnizuara sipas kontrates duhet te jene konform kodeve dhe Standardeve Teknike te parashikuara ne specifikimet teknike. Nese gjate ekzekutimit te kontrates, ka ndryshime ne kodet perkatese ose ne Standardet Teknike, keto ndryshime do te zbatohen vetem pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.
- 9.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet nga ndonje dispozite tjeter e kontrates, kur nuk eshte percaktuar asnje Standard Teknik perkates ne specifikimet teknike, Mallrat duhet te jene konform Standardeve Teknike nderkombetare. Nese nuk ekzistojne Standarde Teknike nderkombetare, Mallrat duhet te jene konform Standardeve Teknike perkatese Shqiptare.
- 9.3 Kontraktuesi nuk mban pergjegjesi per gabime ne skicim, te dhena, vizatim ose çdo aspekt tjeter te specifikimeve teknike te dhena nga Autoriteti Kontraktor me perjashtim te rastit kur gabimi ishte aq i dukshem sa Kontraktuesi duhet ta kishte pare dhe keshilluar Autoritetin Kontraktor per te.
- 9.4 Shitesi (Kontraktuesi) nuk mban pergjegjesi per defekte te Mallrave per te cilat Autoriteti Kontraktor ishte ne dijeni ne momentin e lidhjes se kontrates ose nuk ishte ne dijeni per faj te tij, me perjashtim te rastit kur defektet kane te bejne me cilesine e Mallrave te specifikuar sipas kontrates ose perfaqesimin e reklames se shitesit (Kontraktuesit).

#### **Neni 10: Pjeset e Kembimit**

- 10.1 Nese eshte e parashikuar ne kontrate, Kontraktuesi duhet te perfshije me Mallrat e levruara nje sasi pjesesh kembimi, ne perputhje me specifikimet teknike dhe çdo dispozite perkatese te kontrates.



- 10.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe, pjeset e kembimit do te dorezohen bashke me Mallrat.
- 10.3 Kontraktuesi duhet te garantoje disponueshmerine e pjeseve te kembimit per nje periudhe te specifikuar ne oferten e tij dhe te barabarte me jetegjatesine e perdorimit te Mallrave.
- 10.4 Ne rast te nje vendimi te nderprerjes se prodhimit te pjeseve te kembimit, Kontraktuesi duhet te njoftoje Autoritetin Kontraktor brenda nje kohe te arsyeshme/mjaftueshme per t'i lene mundesi atij qe te prokuroje sasi te mjaftueshme per perdorim te mevonshem.
- 10.5 Pas nderprerjes se prodhimit te pjeseve te kembimit, Kontraktuesi duhet t'i jape pa pagese Autoritetit Kontraktor, nese ai e kerkon, çdo prodhim, vegjel, skicim te pjeseve te kembimit te perdurura ne prodhimin dhe mirembajtjen e Mallrave.

#### **Neni 11: Ambalazhimi**

- 11.1 Kontraktuesi duhet te dorezoje Mallrat te vendosura dhe te ambalazhuara ne menyren e percaktuar ne kontrate.
- 11.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet nga ndonje nen tjetër i kontrates, mund te thuhet se Mallrat nuk jane vendosur dhe paketuar ne perputhje me kontraten nese ato nuk jane vendosur dhe paketuar ne te njejten menyre qe behet zakonisht per gjerat e te njejtit lloj ose, nese menyra e zakonshme nuk eshte e disponueshme, ne nje menyre qe eshte e pershtatshme per ruajtjen dhe mbrojtjen e Mallrave.

#### **Neni 12: Testimet dhe Inspektimet**

- 12.1 Kontraktuesi duhet te beje te gjitha testet dhe inspektimet e kerkuara nga dispozitat e kontrates. Kosto e ketyre testimeve dhe inspektimeve duhet te financohet teresisht nga Kontraktuesi brenda kushteve te çmimit te kontrates
- 12.2 Me shpenzimet e tij, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te ndjeke testimet dhe/ose inspektimet.
- 12.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kerkoje Kontraktuesit te beje testimet ose inspektimet shtese te paparashikuara ne kontrate por te gjykuara te nevojshme per te verifikuar se Mallrat jane konform specifikimeve dhe kushteve te kontrates. Autoriteti kontraktor do te mbaje pergjegjesi per koston e ketyre testimeve. Me tej, nese keto teste ndalojne progresin e punes se Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktor do te pranoje te ndryshoje grafikun e levrimit.
- 12.4 Autoriteti Kontraktor do te refuzoje çdo Mall qe nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk eshte konform specifikimeve teknike dhe kushteve te kerkuara ne zbatimin e kontrates.

- 12.5 Ekzekutimi i testeve, apo inspektimi i Mallrave nuk e shkarkojne Kontraktuesin nga garancite apo detyrimet e tjera sipas kontrates.

### **Neni 13: Kushtet e Dorezimit**

- 13.1 Kontraktuesi eshte i detyruar te kryeje te gjitha aktivitetet dhe veprimet e dorezimit pervecse kur Kontraktuesi perjashtohet ne menyre specifike nga nje aktivitet ose veprim i tille nga ndonje dispozite e kontrates. Nese nje Incoterm perdoret per te pershkruar detyrimet e paleve, termi do te kete kuptimin qe i ka dhene botimi i fundit i *Incotermave* botuar nga Dhoma Nderkombetare e Tregtise.
- 13.2 Vendi i dorezimit te Mallrave do te jete sipas specifikimit te kontrates.
- 13.3 Koha e dorezimit te Mallrave dhe data e perfundimit te Sherbimeve te lidhura me to do te jete sipas specifikimit ne kontrate.
- 13.4 Dorezimi i Mallrave duhet te behet gjate orarit te punes me perjashtim te rastit kur kjo kerkese bie ndesh me ndonje dispozite te kontrates.
- 13.5 Kontraktuesi eshte i detyruar te njoftoje Autoritetin Kontraktor brenda nje periudhe kohore te arsyeshme per dorezimin e Mallrave perpara arritjes se tyre.

### **Neni 14 Transportimi i Mallrave**

- 14.1 Kontraktuesi eshte i detyruar te siguroje ngarkimin dhe transportimin e Mallrave siç kerkohet, me qellim qe te plotesoje afatet dhe kushtet e dorezimit te specifikuar ne kontrate.
- 14.2 NeAutoriteti Kontraktor eshte i detyruar te marre Mallrat nga ndonje mjet transporti apo agjenci transporti, Kontraktuesi duhet te jape lajmerim paraprak te arsyeshem per transportin dhe t'i dorezoje Autoritetit Kontraktor te gjitha dokumentat e nevojshme per marrjen e Mallrave.
- 14.3 Nese shitesi, [Kontraktuesi] eshte i detyruar t'i dorezoje mallrat ne mjetin e transportit ne nje vend te specifikuar ne kontrate, risku i humbjes kalon tek Autoriteti Kontraktor vetem kur mallrat i dorezohen mjetit te transportit ne vendin e specifikuar. Fakti se shitesi [Kontraktuesi] eshte i autorizuar te mbaje dokumentat perfaqesuese te mallrave nuk influencon ne kalimin e rrishtit.

### **Neni 15: Siguracioni**

- 15.1 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kontrate, Kontraktuesi duhet te siguroje qe Mallrat qe do te dorezohen sipas kontrates jane plotesisht te siguruar ndaj humbjes ose demtimit gjate transportit, magazinimit ose dorezimit te tyre.

### **Neni 16: Verifikimi dhe Pranimi i Mallrave**

- 16.1 Perpara pranimit, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te verifikoje, inspektoje dhe testojë Mallrat. Keto veprime duhet te kryhen menjehere pas dorezimit te Mallrave. Kontraktuesi ka te drejte te marre pjese ne kete proces dhe te shqyrtojë raportet perkatese te prer gatitura nga Autoriteti Kontraktor ose agjentet e tij.
- 16.2 Autoriteti Kontraktor pranon ose refuzon Mallrat menjehere pas dorezimit duke njoftuar me shkrim Kontraktuesin ne lidhje me vendimin e tij per te pranuar ose refuzuar Mallrat.

### **Neni 17: Garancite**

- 17.1 Kontraktuesi garanton se Mallrat jane te reja, te paperdorura dhe te modeleve te fundit dhe se ato trupezojne permiresimet e fundit ne skicim dhe materiale, me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kontrate.
- 17.2 Shitesi (Kontraktuesi) mban pergjegjesi per çdo defekt ose mosperputhje qe ekziston ne momentin kur risku kalon tek Autoriteti Kontraktor, edhe kur defekti shfaqet pas ketij momenti.
- 17.3 Shitesi (Kontraktuesi) mban pergjegjesi per mosperputhjen qe verifikohet pas momentit te treguar ne paragrafin e mesiperme dhe qe vjen nga mospermbushja e ndonje detyrimi, duke perfshire garancine qe Mallrat duhet te jene te pershtatshme per perdorimin e tyre te zakonshem dhe specifik per nje periudhe te caktuar kohe, ose se ato do te ruajne cilesite dhe karakteristikat e caktuara.
- 17.4 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne kontrate ose ne ligj, Autoriteti Kontraktor humbet te drejten e tij per te kundershuar lidhur me te metat e sendit nese ai nuk i denoncon ato te shitesi (Kontraktuesi), duke specifikuar natyren e tyre, brenda dhjete diteve nga zbulimi i tyre.
- 17.5 Autoriteti Kontraktor s i mundeson Kontraktuesit te gjitha mjetet e nevojshme per te inspektuar keto defekte.
- 17.6 Pas marrjes se ketij njoftimi, Kontraktuesi duhet te riparoje menjehere ose te zevendesojë Mallrat defektoze ose pjeset e tyre pa pagese shtese per Autoritetin Kontraktor.
- 17.7 Nese pas marrjes se njoftimit, Kontraktuesi deshton ne rregullimin e defektit brenda nje periudhe te arsyeshme, Autoriteti Kontraktor mund te ndermarre veprime per rregullimin e nevojshem, me shpenzimet e Kontraktuesit.
- 17.8 Ne çdo rast, Autoriteti Kontraktor humbet te drejten per te kundershuar per te metat e sendit nese ai nuk e ushtron te drejten e tij brenda dy vjetesh nga data kur sendet i jane dorezuar atij, po qe se ky afat nuk bie ne kundershkim me kohezgjatjen e garancise kontraktore.

- 17.9 Shitesi (Kontraktuesi) nuk mund të shfrytëzojë rregullat e parashikuara këtu nëse defektet kanë të bëjnë me fakte të njohura prej tij ose që nuk mund të ishin të panjohura për të dhe që nuk i janë vënë në dukje Autoritetit Kontraktor.

#### **Neni 18: Çmimi i Kontrates**

- 18.1 Çmimi i kontrates është çmimi i dhënë në ofertën e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktor.
- 18.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, çmimi i kontrates përfshin kostot dhe tarifën, duke përfshirë taksat dhe tarifën doganore të lidhura me dorezimin e Mallrave, pagesa për transportin, sigurimin, instalimin, testimet, ngarkimin, shkarkimin, udhëzimet, manualët dhe dokumentat në gjuhën e specifikuar dhe të nevojshme për përdorim të rregullt, mirëmbajtje dhe riparime të Mallrave. Vlera e taksave dhe tarifave duhet të përcaktohet sipas legjislacionit përkatës, në fuqi 28 ditë para hapjes së ofertave.

#### **Neni 19: Afatet e Pageses**

- 19.1 Çmimi i kontrates, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhet në kohë siç specifikohet në kontratë.
- 19.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë i fiksuar në ditën e dërgimit për botim të njoftimit të kontrates.
- 19.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoritetit Kontraktor me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan Mallrat e dorezuara dhe shërbimet e kryera.
- 19.4 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa për Mallrat do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita që janë pranuar Mallrat ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë me vone.
- 19.5 Data e pageses do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

#### **Neni 20: Vonesa në Berjen e Pageses**

Në rast të verifikimit të vonësave në kryerjen e pagesave nga ana e Autoritetit Kontraktor, megjithatë kontraktuesi ka përbushur të gjitha detyrimet e tij në përputhje me kushtet e kontrates, detyrimet e prapambetura dhe kamatevonesat përkatëse do të kryhen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare".

#### **Neni 21: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

21.1 Nese pas dates se nenshkrimit te kontrates, ndonje ligj, rregullore, urdherese, urdher ose procedure me efektin e ligjit ne Republiken e Shqiperise hyn ne fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke perfshire daten e dorezimit, ose çmimin e kontrates, kushtet ose çmimi i kontrates do te rregullohen ne ate mase sa Kontraktuesi eshte ndikuar ne permbushjen e detyrimeve te tij sipas kontrates.

#### **Neni 22: Forca Madhore**

22.1 Kontraktuesi nuk mban pergjegjesi per humbjen e sigurimit te kontrates, demeve te likuiduara ose nderprerjen per mosplotesim, nese dhe deri ne masen qe vonesa ne zbatim ose ndonje deshtim tjeter ne zbatimin e detyrimeve te tij sipas kontrates vijne si rezultat i verifikimit te rasteve te Forces Madhore.

22.2 Per qellimet e ketij neni "Force Madhore" do te thote nje ngjarje jashte kontrollit te Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin dhe e paparashikueshme nga ana e tij. Ngjarje te tilla mund te perfshijne, por nuk jane te limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor qofte ne kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, permbytja, termeti, epidemite, shtrengime te karantines dhe embargo tranziti.

22.3 Nese ndodh ndonje situatë e Forces Madhore, Kontraktuesi duhet te njoftoje menjehere Autoritetin Kontraktor. Me perjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva te ndryshme, Kontraktuesi duhet te vazhdoje te zbatoje detyrimet e tij sipas kontrates ne masen praktikisht te arsyeshme dhe duhet te kerkoje te gjitha mjetet e arsyeshme per zbatimin qe nuk pengohet nga Forca Madhore.

#### **Neni 23: Vonesa ne Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

23.1 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet te filloje zbatimin e kontrates menjehere pas nenshkrimit te saj.

23.2 Me perjashtim te rasteve kur Autoriteti Kontraktor eshte dakord per zgjatje te afatit te kontrates, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te likuidoje demet per vonesen ne zbatim nese Kontraktuesi deshton ne dorezimin e Mallrave brenda periudhes se zbatimit te specifikuar ne kontrate.

23.3 Autoriteti Kontraktor mund te zbrese shumen e demeve te likuiduara qe duhet paguar nga shuma e pageses ndaj Kontraktuesit. Ne rast te tille Autoriteti Kontraktor duhet te njoftoje Kontraktuesin me shkrim per shumen dhe arsyen e zbritjes.

23.4 Autoriteti Kontraktor pranon zgjatjen e afatit ne rastin e Forces Madhore.

23.5 Autoriteti Kontraktor mund pranoje zgjatjen e afatit edhe ne rrethana te tjera nese eshte ne interesin publik per ta bere kete. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte qe pengojne zbatimin ne kohe, Kontraktuesi duhet te njoftoje me perpikmeri Autoritetin Kontraktor me shkrim per vonesen, shkakun dhe daten e propozuar te dorezimit ose perfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet te vleresoje kerkesen. Nese

Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

#### **Neni 24: Likuidimi i Demeve për Dorezimin e Vonuar**

24.1 Dëmet e likuiduara për dorezimin e vonuar do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore::

- a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
- c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

#### **Neni 25: Negociatat dhe Amendamentet**

25.1 Palet nuk mund të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të sillnin ndryshime thelbësore në kushtet bazë për përzgjedhjen e Kontraktuesit.

25.2 Asnjë amendament ose ndryshim tjetër i kontratës nuk është i vlefshëm nëse ai nuk bëhet me shkrim apo nuk ka një datë të përcaktuar, si edhe nëse ai nuk i referohet shprehimisht kontratës apo nuk nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoriteti Kontraktor.

25.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palet sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqësues i autorizuar i pales që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo leshohet.

#### **Neni 26: Ndryshimi i Porosise**

26.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosise Mallra ose Shërbime shtese deri në një masë që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtese duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

#### **Neni 27: Nderprerja për Mosplotesim**

27.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërprejë kontratën në teresi ose pjesërisht nëse:

- a) Kontraktuesi deshton ne dorezimin e Mallrave brenda periudhes se specifikuar ne kontrate ose brenda zgjatjes se dhene; ose,
- b) Kontraktuesi deshton te zbatoje ndonje detyrim tjetër te kontrates.

27.2 Autoriteti Kontraktor duhet te njoftoje me shkrim Kontraktuesin per nderprerjen per mosplotesim dhe t'i jape Kontraktuesit 15 dite te ndreqe mosplotesimin me perjashtim kur nderprerja eshte bere per veprime korruptive ose te paligjshme, rast ne te cilin nderprerja do te jete e menjehershme.

#### **Neni 28: Nderprerja per Shkak te Falimentimit**

28.1 Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne çdo kohe nese Kontraktuesi falimenton ose behet i paafte te paguaje.

28.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim per nderprerjen.

#### **Neni 29: Nderprerja per Shkak te Interesit Publik**

29.1 Autoriteti Kontraktor mund te nderprese kontraten ne çdo kohe nese gjykon se ky veprim duhet ndermarre per t'i sherbyer sa me mire interesit publik.

29.2 Autoriteti Kontraktor duhet te njoftoje me shkrim Kontraktuesin per nderprerjen..

29.3 Autoriteti kontraktor duhet te paguaje Kontraktuesin per te gjitha Mallrat e pranuar dhe Sherbimet e lidhura me to te kryera perpara nderprerjes dhe duhet t'i paguaje Kontraktuesit demet e shkaktuara per kryerjen e pjesshme te Mallrave dhe Sherbimeve te lidhura me to. Ne llogaritjen e shumes se demeve, Kontraktuesit do t'i kerkohet te ndermarre te gjitha veprimet e nevojshme per te minimizuar demet.

#### **Neni 30: Nenkontraktimi**

30.1. Nje nenkontrate do te jete e vlefshme vetem nese eshte ne formen e nje marreveshjeje te shkruar me ane te se ciles kontraktori i beson kryerjen e nje pjese te detyrimeve te kontrates se tij nje pale te trete.

30.2 Kontraktori nuk duhet te nenkontraktoje pa aprovimin paraprak me shkrim te Autoritetit Kontraktor dhe jo me shume se 40% te vleres se kontrates. Kontraktori duhet te njoftoje Autoritetin Kontraktor per elementet e kontrates qe nenkontraktohet dhe dokumentacionin qe provon aftesine e nen kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet te lajmeroje kontraktorin per vendimin e tij, brenda 5 diteve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nese e aprovon apo jo ate.

30.3 Çdo nenkontraktor ka te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund te parashikojë pagesa direkte tek nenkontraktori per mallrat qe do te furnizojë.

30.4 Kontraktori mbetet plotesisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 31: Transferimi i të Drejtave**

31.1 Kontraktuesi nuk mund të transferojë, teresisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

**Neni 32: Sigurimi i Kontrates**

32.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

32.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga deshtimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

32.3 Garancia e sigurimit të kontratës do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së pranimit të Mallrave. Megjithatë, pesë (5) përqind e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kërkesave të detyrimeve të kontratës.

**Neni 33: Baza Ligjore**

33.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 34: Zgjidhja e Mosmarreveshjeve**

34.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarreveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këto marreveshje me negociata direkte.

34.2 Nëse palët deshtojnë në zgjidhjen e mosmarreveshjes ose konfliktit, problemi do të konsiderohet me anë të zgjidhjes së mosmarreveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 35: Përfaqësimi i Paleve**

35.1 Çdo pale duhet të emerojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të pales, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e pales në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

35.2 Secila pale duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të pales. Nëse njëra pale deshton të lajmërojë, duhet të marrë për siper çdo humbje të shkaktuar nga deshtimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.



35.3 Palet mund të emerojnë persona ose njësi organizative shtese për të përfaqësuar palen në veprime ose veprimtari të veçanta, rast në të cilin njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

**Neni 36: Lajmerimet**

36.1 Çdo lajmerim i dhënë nga njëra palë tjetër sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

36.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 37: Llogaritja e Afateve**

37.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike.

## Shtojca 17

[ Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### **KUSHTET E VEÇANTA Mallrat – Procedure e Hapur**

Kushtet e veçanta te Kontrates hartohen ne perputhje me objektin konkret te kontrates. Ne rast se ka mosperputhje midis KPK dhe KVK do te mbizoterojne Kushtet e veçanta te kontrates.

#### **Neni 1: Perkufizime**

- 1.1 Autoriteti Kontraktor eshte \_\_\_\_\_
- 1.2 Kontraktuesi eshte \_\_\_\_\_

#### **Neni 2: Sigurimi i Kontrates**

- 2.1 Sigurimi i Kontrates ne shumen prej (10% te vleres se ofertes) duhet te ofrohet nga Kontraktuesi per te siguruar egzekutimin e detyrimeve te tij sipas kontrates.
- 2.2 Sigurimi i Kontrates do t'i leshohet ose kthehet, menjehere Kontraktuesit sipas formularit te meposhem: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

#### **Neni 3: Fillimi i Zbatimit**

- 3.1 Zbatimi i kontrates duhet te fillojee me \_\_\_\_\_. Nese data nuk eshte e percaktuar, zbatimi do te filloje ne daten qe Kontraktuesi nenshkruan formularin e kontrates.

#### **Neni 4: Inspektimet dhe Testimet**

- 4.1 Inspektimet dhe testimet para pranimit te Mallrave do te behen: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

#### **Neni 5: Kushtet e Dorezimit**

- 5.1 Data (t) dhe vendi (et) i dorezimit te Mallrave do te behet sipas Grafikut te Levrimet te parashikuar ne kete kontrate.
- 5.2 Kontraktuesi duhet te njoftoje Autoritetin Kontraktor \_\_\_\_\_ dite para çdo dorezimi te Mallrave.

- 5.3 Lajmerimi i dorezimit duhet te behet me shkrim, faks, poste, e-mail etj, tek: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_
- 5.4 Nese Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga nje pale e trete, lajmerimi i dorezimit duhet te perfshije listen e dokumentave te nevojshme per marrjen e Mallrave dhe te tregojte se ku dhe kur do t'i jepen dokumentat Autoriteti Kontraktor.
- 5.5 Nese Autoriteti Kontraktor i merr Mallrat nga nje pale e trete, Kontraktuesi duhet te dorezoje te gjitha dokumentat e nevojshme per marrjen e Mallrave tek: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Neni 6: Kushtet e Pageses**

- 6.1 Pagesa e Mallrave duhet bere brenda \_\_\_\_\_ diteve nga data e pranimit te Mallrave ose nga data e marrjes se kerkeses me shkrim te pageses, sado vone qe te vije. Nese nuk eshte specifikuar, periudha kohore do te jete 30 dite.
- 6.2 Monedha e pageses do te jete \_\_\_\_\_. Nese eshte lene e paplotesuar, pagesa do behet me monedhen Shqiptare.

**Neni 7. Pagesa Paraprake**

- 7.1 Perqindja e pageses paraprake do te jete \_\_\_\_\_. Nese nuk eshte specifikuar, Kontraktuesi nuk do te marre pagese paraprake.
- 7.2 Nese eshte premtuar nje pagese paraprake, avanca do te paguhet brenda \_\_\_\_\_ diteve nga marrja e sigurimit te kontrates.
- 7.3 Nese jepet pagesa paraprake, shuma do te hiqet nga pagesa qe duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formules se meposhtme: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Neni 8. Sherbimet ne Lidhje me to**

- 8.1 Kushtet e veçanta te meposhme do te zbatohen per kryerjen e pageses se sherbimeve te lidhura  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Neni 9. Zbritja e garancise se kontrates**

- 9.1 Nese parashikohet zbritje periodike te garancise se kontrates ajo kryhet si me poshte  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Nese nuk plotesohet, garancia mbetet e pandryshuar.

## Shtojca 18

[ Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I PUBLIKIMIT TE NJOFTIMIT TE KONTRATES SE NENSHKRUAR

#### Seksioni 1 Autoriteti Kontraktor

##### 1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Faqja ne Internet \_\_\_\_\_

##### 1.2 Lloji i autoritetit kontraktor:

Institucion Qendror	Institucion i Pavarur
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Njesi e Qeverisjes Vendore	Tjeter
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

#### Seksioni 2. Objekti i Kontrates

2.1 Numri i references se procedures/lotit \_\_\_\_\_

##### 2.2 Lloji i “Kontratave Publike per Mallra”

Blerje	Qira	Leasing	Blerje me keste	Nje kombinim i tyre
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

##### 2.3 Kontrate ne baze te Marreveshjes Kuader

Po  Jo

Nese Po, lloji i Marreveshjes Kuader

Me 1 Operator Ekonomik

Me disa operatore ekonomike

Te gjitha kushtet jane te percaktuara Po  Jo

## 2.4 Pershkrim i shkurter i kontrates

1 Fondi limit \_\_\_\_\_

2. Burimi i Financimit \_\_\_\_\_

3. Objekti i kontrates/marreveshjes kuader \_\_\_\_\_

## 2.5 Kohezgjatja e kontrates ose afati kohor per ekzekutimin:

Kohezgjatja ne muaj  ose dite

ose

duke filluar nga  me perfundim ne

## 2.6 Ndarja ne LOTE:

Po  Jo

Nese Po, numri i LOTEVE:

## 2.7 Opsionet:

Numri i rinovimeve te mundshme(nese ka):

ose: nga  ne

## 2.8 Kontrate me nenkontraktim:

Po  Jo

## Seksioni 3. Procedura

### 3.1 Lloji i procedures: E Hapur

### 3.2 Kriteret e perzgjedhjes se fituesit:

A) çmimi me i ulet

ose

B) oferta ekonomikisht me e favorshme

lidhur me rendesine: Çmimi  pike   
etj.  pike

3.3 Numri i ofertave te dorezuara:

Numri i ofertave te rregullta:

3.4. Gjate procesit te prokurimit ne fushen e Teknologjise te Informacionit dhe Komunikimit (TIK) jane perdorur standartet e pergatitura nga Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit:

Po  Jo

3.5. Gjate procesit te prokurimit ne fushen e Teknologjise te Informacionit dhe Komunikimit (TIK), ne rastin kur standartet jane te paaplikueshme, eshte marre miratimi paraprak nga Agjencia Kombetare e Shoqerise se Informacionit

Po  Jo

#### Seksioni 4 Informacion mbi kontraten

4.1 Numri i Kontrates: \_\_\_\_\_ Data e Kontrates //

#### 4.2 Emri dhe adresa e kontraktorit

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Faqja e Internetit \_\_\_\_\_

#### 4.2.1 Emri dhe adresa e nenkontraktorit/eve

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_

Faqja e Internetit \_\_\_\_\_

**4.3 Vlera totale perfundimtare e kontrates** (duke perfshire lotet opsionet dhe nenkontraktimin):

Vlera \_\_\_\_\_ (pa TVSH) Monedha \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ (me TVSH) Monedha \_\_\_\_\_

**4.3.1 Vlera totale e nenkontraktimit :** \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ (pa TVSH) Monedha \_\_\_\_\_

Vlera \_\_\_\_\_ (me TVSH) Monedha \_\_\_\_\_

**4.4 Informacione shtese**

---

---

Data e shperndarjes se ketij njoftimi   /   /

**Shtojca 18/1**

[ Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor per publikim ne Buletinin e Njoftimeve Publike]

**1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Tel/Fax \_\_\_\_\_  
E-mail \_\_\_\_\_  
Faqja ne Internet \_\_\_\_\_

**2. Lloji i procedures:** \_\_\_\_\_

**3. Objekti i kontrates/marreveshjes kuader** \_\_\_\_\_

**4.Numri i references se procedures/lotit** \_\_\_\_\_

**5. Fondi limit** \_\_\_\_\_

**6. Vlera totale perfundimtare e kontrates** *(duke perfshire lotet opsionet dhe nenkontraktimin):*

Vlera \_\_\_\_\_ *(me TVSH)* Monedha \_\_\_\_\_

Vlera e nenkontraktimit \_\_\_\_\_ *me Tvsh* Monedha \_\_\_\_\_

**7. Data e lidhjes se kontrates** \_\_\_\_\_

**7. Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit**

Emri \_\_\_\_\_  
Adresa \_\_\_\_\_  
Nr. NIPT \_\_\_\_\_



## Shtojca 19

[Leter me koke e Bankes / Kompanise se Sigurimeve]

[ Shtojce per t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

### FORMULARI I SIGURIMIT TE KONTRATES

[Data]

Per: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Ne emer te: [Emri dhe adresa e ofertuesit te siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit: [lloji i procedures ]

Pershkrim i shkurter i kontrates: [ objekti]

Publikimi (nese zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

\* \* \*

Duke iu referuar procedures se lartpermendur, dhe me kusht qe [emri i ofertuesit te percaktuar fitues] t'i jete akorduar kontrata,

Ne vertetojme se [emri i ofertuesit te percaktuar fitues] ka derdhur nje depozite prane [emri dhe adresa e bankes / kompanise se sigurimeve] ne nje shume prej [monedha dhe vlera, e shprehur ne fjale dhe shifra] si kusht per sigurimin e ekzekutimit te kontrates, qe do te nenshkruhet me [emri i autoritetit kontraktor]

Marrim persiper te transferojme ne llogarine e [emri i autoritetit kontraktor] vleren e siguruar, brenda 15 (pesembedhete) diteve nga kerkesa juaj e thjeshte dhe e pare me shkrim, pa kerkuar shpjegime, me kusht qe kjo kerkesa te permende mos-permbushjen e kushteve te kontrates.

Ky Sigurim eshte i vlefshem deri ne zbatimin plote te kontrates.

[Perfaqesuesi i bankes / kompanise se sigurimeve]

**Shtojca 20**

**FORMULARI I ANKESES PRANE AUTORITETIT KONTRAKTOR**

*Ankese drejtuar:*     *Autoriteti Kontraktor*

**Seksioni I. Identifikimi i Ankimuesit**

*Ankimuesi mund te jete nje ofertues ose ofertues i mundshem (psh, si individ, ne partneritet, ne bashkepunim, ne bashkim shoqerish).*

---

Emri i plote i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

---

Adresa

---

Qyteti

---

Shteti

---

Kodi Postar/Kodi  
Zip

---

Nr. Telefoni (duke perfshire edhe  
prefiksin e zones)

---

Nr. Faksi (duke perfshire edhe prefiksin  
e zones)

---

E-mail

---

Emri dhe pozicioni i zyrtarit te autorizuar qe ploteson ankesen (ju lutem, shtypeni)

---

Firma e zyrtarit te autorizuar

---

Data (viti/muaji/dita)

---

Nr. Telefoni (duke perfshire prefiksin e  
zones)

---

Nr. Faksi (duke perfshire prefiksin e  
zones)

## **Seksioni II. Informacion per Proceduren**

### **1. Numer Identifikimi**

*Plotesoni numrin e kontrates ne njoftimin e kontrates ose ne dokumentat e tenderit, duke perfshire llojin e procedures se perdorur per prokurimin ne fjale (psh, Kerkese per Propozime(KP), Procedure e Hapur(PH), Procedure e Kufizuar(PK), Procedure me Negociim(PN), Sherbim Konsulence (SHK), Konkurs Projektimi (KP).*

---

### **2. Autoriteti Kontraktor**

*Emri i autoritetit kontraktor qe administron procesin e prokurimit.*

---

### **3. Vlera e Perlogaritur e Prokurimit**

*Llogaritja e vleres se kontrates (shuma e shprehur ne shifra dhe fjale)*

---

### **4. Objekti i Kontrates**

*Pershkrim i shkurter i puneve/mallrave/sherbimeve qe blihen.*

---

### **5. Afati Perfundimtar per Dorezimin e Ofertes**

*Afati perfundimtar per dorezimin e ofertave.*

---

Data (viti/muaji/dita)

### **6. Data e Percaktimit te Kontrates Fituese**

Data (viti/muaji/dita) nese zbatohet

---

## **Seksioni III. Pershkrimi i ankeses**

### **1. Baza Ligjore e Ankeses**

*(shkruani shkeljen ligjore, bazuar ne vendime, akte, dokumenta, etj)*

---

## 2. Deklarate e Hollesishme e Fakteve dhe Argumenteve

*Jepni nje deklarate te hollesishme te fakteve dhe argumenteve qe mbeshtetin ankesen tuaj. Per çdo arsye te ankeses specifikoni daten ne te cilen u vute ne dijeni per faktet e lidhura me arsyet e ankeses. Permendni edhe seksionet perkatese te dokumentave te tenderit, nese zbatohen. Perdorni faqe shtese, nese eshte e nevojshme.*

## 3. Lista e Shtojcave

*Qe nje ankese te konsiderohet e dorezuar, ajo duhet te jete e plote. Bashkangjisni nje kopje te lexueshme te te gjitha dokumentave qe kane lidhje me ankesen tuaj dhe nje liste te te gjitha ketyre dokumentave. Dokumentat duhet te perfshijne normalisht **çdo njoftim te publikuar, te gjitha dokumentat e tenderit, me te gjitha ndryshimet dhe shtojcat, propozimin tuaj**. Percaktoni se cili prej informacioneve eshte konfidencial, nese ka te tille. Shpjegoni se perse informacioni eshte i tille, ose dorezoni nje version te dokumentave perkatese me pjeset konfidenciale te hequra dhe nje permbledhje te permbajtjes.*

---

Dergojeni formularin e plotesuar te ankeses per prokurimin, te gjitha shtojcat e nevojshme dhe disa kopje shtese, prane **autoritetit kontraktor**

Shenim: Per ankesat prane Komisionit te Prokurimit Publik duhet ti referoheni Formulari te Ankeses se nxjerre nga ky institucion.

**Nr. Faks:**

**E-mail:**

**Nenshkrimi dhe Vula e ankuesit**

## Shtojca 21

**DRAFTI I MARREVESHJES KUADER**  
( KU TE GJITHA KUSHTET JANE TE PERCAKTUARA)  
**PER PUNE / MALLRA / SHERBIME**

[Perdorimi i ketij draft marreveshje eshte detyruese per te gjitha Autoritetet  
Kontraktore qe do te perdorin marreveshjen kuader)

Nr \_\_  
**DATA:**

Kjo kontrate lidhet me [data], midis [emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor] tani e tutje te referuar si “Autoriteti Kontraktor” dhe [emri dhe adresa e Kontraktuesit] te perfaqesuar nga [perfaqesuesi], tani e tutje i quajtur si “Kontraktuesi”.

Kontraktori, me ane te ofertes se tij, me date [data] bie dakord te furnizojë mallrat, ashtu siç janë të specifikuar në kushtet e percaktuara ne:

- Kete kontrate
- Formularin e Deklarimit te Ofertes, te paraqitur nga Ofertuesi
- Specifikimet Teknike
- Formularin e çmimit te ofertes

Te gjitha keto dokumenta te bashkangjitur perbejne pjese integrale te kesaj kontrate.

### **Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i marreveshjes kuader eshte te percaktoje kushtet, perfshire çmimet per njesi dhe rregullat per dorezimin e mallrave/sherbimeve/puneve ne vijim.

[pershkrimi i pergjithshem]

1.2 Marreveshja kuader do te zbatohet me dergimin e ftesave per oferte tek operatorët ekonomike, pale ne marreveshje. P.sh. kurdohere qe Autoriteti Kontraktor i perfshire ne kete marreveshje, do te bleje artikuj ne baze te kesaj kontrate, duhet qe te dergoje “ftesen per oferte” tek kontraktuesi, duke specifikuar listen me artikuj per furnizim me sasite e tyre perkatese.

1.3 Sasite e parashikuara, jane vetem sasi orientuese dhe NUK e kushtezojne Autoritetin Kontraktor per t’i blere ato. Autoriteti Kontraktor ka te drejte te bleje me pak apo me shume sasi se sa ato te parashikuara.

1.4 Kontraktuesi nuk do te kete te drejte kompensimi dhe NUK do t’i lejohet te beje ndryshime te çmimeve te njesise, per shembull ne rast se autoriteti kontraktor vendose te bleje me pak apo me shume sasi se sa ato te specifikuar dhe/ose ne rast se autoriteti kontraktor vendos te mos bleje asnje nga keto sasi per disa artikuj.

1.5 Kohezgjatja e marreveshjes kuader:

---

**Neni 2 Çmimi**

- 2.1 Çmimet per njesi per pune/mallra /sherbime jane treguar ne Formularin e Cmimit te Ofertes.
- 2.2 Çmimet e njesive duhet te jene fikse dhe nuk duhet t'i nenshtrohen ndryshimeve per porositet e vendosura ne kete marreveshje kuader.

**Nenshkrimet dhe Datat**

<b>Per Kontraktuesin</b>		<b>Per Autoritetin Kontraktues</b>	
<b>Emri:</b>		<b>Emri:</b>	
Pozita:		Pozita:	
Nenshkrimi:		Nenshkrimi:	
Data:		Data:	
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	

## Shtojca 22

### **DRAFTI I MARREVESHJES KUADER ( KU JO TE GJITHA KUSHTET JANE TE PERCAKTUARA) PER PUNE / MALLRA / SHERBIME**

**Emri i Autoritetit Kontraktues,**

Dhe

#### **Emri i Kontraktuesit**

Bien dakord si vijon:

**Te nenshkruajne kete Marreveshje kuader per objektin :** < vendosni titullin > me numrin identifikues : <*vendosni Numrin e Prokurimit*>

#### **Neni 1 Objekti**

1.1 Objekti i kesaj marreveshje kuader eshte te vendose rregullat per kontratat te cilat do te lidhen permes procesit te mini-konkursit vetem ndermjet operatoreve ekonomike qe jane pale e kesaj marreveshje kuader.

1.2 Kjo marreveshje kuader nuk eshte nje kontrate ne vete, por percakton kushtet per kontratat qe do te lidhen ne baze te saj.

1.3 Kontraktuesi eshte vetem nje nga palet e marreveshjes kuader.

#### **Neni 2 Detyrimet e Paleve**

2.1 Autoriteti Kontraktues, pale ne kete marreveshje, do t'i dergoje kontraktuesit "Ftesen per Oferte" kurdo qe paraqitet nevoja per pune/mallra/sherbime.

2.2 Kontraktuesi, detyrohet te dorezoje nje oferte kurdo qe kerkohet nga Autoriteti Kontraktor.

#### **Neni 3 Kontratat ne zbatim te marreveshjes kuader**

3.1 Kontratat do te nenshkruhen vetem pas procesit te mini-konkursit.

#### **Neni 4 Procesi i mini-konkurrences**

4.1 Procesi i mini- konkursit do te kryhet me te gjithë operoret ekonomike, pale ne marreveshjen kuader, kurdohere qe paraqitet nevoja per pune /mallra/sherbime per Autoritetet Kontraktore.

4.2 Autoriteti Kontraktor do të ri-hape konkursin në bazë të kushteve të njëjta ose të kushteve të tjera të vendosura në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve në dokumentat e tenderit.

4.3 Kurdoherë që paraqitet nevoja për punë/mall /shërbim Autoriteti Kontraktor duhet të përgatisë Ftesat për Ofertë dhe t'ua dërgojë të gjithë operatorëve ekonomikë, pa lehtësi në marrëveshjen kuadër. Vlerësimi i ofertave do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në Ftesën për Ofertë.

## **Neni 5 Kohezgjatja e marrëveshjes kuadër**

---

### **Nenshkrimet dhe datat**

<b>Per Kontraktuesin</b>		<b>Per Autoritetin Kontraktues</b>	
<b>Emri :</b>		<b>Emri:</b>	
Pozita:		Pozita:	
Nenshkrimi:		Nenshkrimi:	
Data:		Data:	
<b>Vula:</b>		<b>Vula:</b>	



**Shtojca 23**

[ *Shtojce per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE ANULIMIT**

**1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor**

Emri \_\_\_\_\_

Adresa \_\_\_\_\_

Tel/Fax \_\_\_\_\_

E-mail \_\_\_\_\_

Faqja ne Internet \_\_\_\_\_

**1. Lloji i procedures:** \_\_\_\_\_

**2. Numri i References:** \_\_\_\_\_

**3. Objekti i kontrates** \_\_\_\_\_

**4. Fondi limit** \_\_\_\_\_

**5. Arsyet e Anulimit:**

Bazuar ne Ligjin Nr. 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar,  
neni 24, pika 1:

a) ;

b) ;

c) ;

ç) ;

d) ;

dh) ;

**Etj.** \_\_\_\_\_

**6. Informacione shtese**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Data e shperndarjes se ketij njoftimi.